



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

DOKUMENTET E PROCEDURËS KONKURRUESE
PËR DHËNIEN ME
KONCESION/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT PËR OFRIMIN E
SHËRBIMIT LABORATORIK TË SPITALEVE UNIVERSITARE,
RAJONALE, DHE ATYRE BASHKIAKE TË SARANDËS E LUSHNJËS

Tabela e përmbajtjes

PËRKUFIZIME.....	5
1 NJOFTIMI I KONTRATËS	8
1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktues.....	8
1.2 Lloji i Autoritetit Kontraktues dhe objekti i aktivitetit të tij ose aktivitetet kryesore	8
1.3 Objekti i Kontratës së Koncesionit	8
1.4 Përmbledhje e kushteve kryesore të Kontratës së Koncesionit.....	8
1.5 Afati i Kontratës së Koncesionit	8
1.6 Vendndodhja e Objektivit të Kontratës	8
1.7 Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik (Dokumentet e Kualifikimit)	8
1.8 Sigurimi i Ofertës.....	8
1.9 Procedura Konkurruese.....	9
1.10 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit.....	9
1.11 Afati i Dorëzimit	9
1.12 Hapja e Ofertave	10
1.13 Periudha e Vlefshmërisë së Ofertave	10
1.14 Gjuha.....	10
1.15 Kostot.....	10
1.16 Tarifa e ankimit.....	10
1.17 Vlera e Kontratës (Projektit).	10
1.18 Data e Shpalljes së Njoftimit të Kontratës	11
UDHËZIME PËR OFERTUESIT – DOKUMENTET E PROCEDURËS KONKURRUESE.....	12
2 HYRJE.....	12
2.1 Informacion i mëtejshëm lidhur me objektin	12
2.2 Objektivi i Koncesionit	13
2.3 Veprimtaritë që do të kryhen nga Koncesionari	13
2.4 Informacioni dhe të dhënat e Projektit	13
2.5 Ligji i zbatueshëm.....	13
3 PROCEDURA KONKURRUESE.....	13
3.1 Sqarime të pyetjeve dhe Ndryshime	13
3.2 Kalendar i Parashikuar	15
3.3 Konferenca e Ofertuesve.....	15
3.4 Vizitat në terren.....	15
3.5 Informacione në formë elektronike.....	15
3.6 Kërkimet dhe studimet e Ofertuesve.....	16
3.7 Konfidencialiteti i Ofertës.....	16
3.8 Konfidencialiteti i informacionit të Autoritetit Kontraktues.....	17
3.9 Përdorimi i dokumenteve të Ofertave	17
3.10 Shpërndarja e informacionit.....	17
3.11 Të drejta shtesë të Autoritetit Kontraktues.....	17
3.12 Informacioni i rremë	18
3.13 Konflikti i interesit	18
3.14 Veprimet e kundraligjshme	18

3.15	Shpenzimet.....	18
3.16	Bashkimi i Shoqërive	19
3.17	Pajtimi me Dokumentet e Procedurës Konkurruese	19
4	PËRGATITJA E OFERTAVE.....	19
4.1	Përmbajtja e Ofertës.....	19
4.2	Gjuha e Ofertës	20
4.3	Referenca të qarta.....	20
4.4	Sigurimi i Ofertës.....	20
4.5	Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës	21
5	DORËZIMI I OFERTAVE.....	21
5.1	Afati i Dorëzimit	21
5.2	Forma e Dorëzimit	22
6	NDRYSHIMI DHE TËRHEQJA E OFERTAVE	22
6.1	Kërkesat për informacion shtesë	22
6.2	Ndryshimi dhe tërheqja e Ofertave	22
6.3	Gabimet e paqëllimshme në Ofertë.....	23
7	RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E OFERTAVE.....	24
7.1	Pas mbarimit të Afatit të Dorëzimit të Ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.....	24
7.2	Vetëm Ofertat e Ofertuesve të Kualifikuar	24
7.3	Ofertat do të kualifikohen në përputhje me kriteret.	24
7.4	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mund të kërkojë sqarime me shkrim nga Ofertuesi,	24
7.5	Komisioni e vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime apo.....	24
7.6	Autoriteti Kontraktues ose Komisioni i Vlerësimit të.....	24
7.7	Autoriteti Kontraktues mund të kryejë çdo hetim të arsyeshëm	24
7.8	Ofertuesi duhet të japë menjëherë informacionin dhe asistencën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e çdo hetimi të nevojshëm.	24
8	KUALIFIKIMI I OFERTAVE	24
8.1	Kualifikimi i Ofertave.....	24
8.2	Dokumentet e Kualifikimit	24
8.3	Shqyrtimi i Dokumenteve të Kualifikimit.....	24
9	VLERËSIMI I OFERTAVE DHE KLASIFIKIMI PËRFUNDIMTAR.....	25
9.1	Oferta Teknike	25
9.2	Oferta Financiare.....	25
9.3	Vlerësimi dhe Klasifikimi Përfundimtar.....	26
10	NËNSHKRIMI I KONTRATËS SË KONCESIONIT	26
11	NEGOCIMI I PASUKSESSHËM ME OFERTUESIN FITUES	27
12	KUFIZIME	27
12.1	E drejta për të pezulluar Procedurën Konkurruese.....	27
12.2	E drejta për ta deklaruar Procedurën Konkurruese “të pasuksesshme”	27
12.3	E drejta për ta deklaruar Ofertën të pavlefshme.....	27

SHËNIM I RËNDËSISHËM

Qeveria Shqiptare, e përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë ("MSH") vë në dispozicion këto dokumente të procedurës konkurruese ("Dokumentet e Procedurës Konkurruese") për t'u përdorur vetëm nga Ofertuesit (sipas përkufizimit më poshtë) gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të Ofertave (sipas përkufizimit më poshtë) si pjesë e Procedurës Konkurruese (sipas përkufizimit më poshtë) në lidhje me Projektin (sipas përkufizimit më poshtë). Ato janë përgatitur me ndihmën e International Finance Corporation ("IFC") në cilësinë e këshilltarit të transaksionit për Projektin.

Ministria e Shëndetësisë, IFC dhe konsulentët apo këshilltarët e tyre përkatës:

- (a) nuk japin asnjë garanci (qoftë të shprehur apo të nënkuptuar) që informacioni i dhënë në këto dokumente apo në çdo dokument tjetër që i vihet në dispozicion një Ofertuesi (në çdo kohë) në lidhje me Procedurën Konkurruese, është i saktë apo i plotë;
- (b) nuk mbajnë asnjë përgjegjësi për këto Dokumentet e Procedurës Konkurruese, për Projektin ose për çdo komunikim të shkruar apo verbal që i transmetohet Ofertuesit në lidhje me Procedurën Konkurruese ose me vlerësimin e Projektit nga një Ofertues; ose
- (c) nuk janë përgjegjës për të rimbursuar apo për t'i kompensuar një Ofertuesi kostot ose shpenzimet e kryera prej tij për vlerësimin apo për veprimin sipas këtyre Dokumenteve të Procedurës Konkurruese apo në lidhje me Procedurën Konkurruese, me Projektin apo çdo gjë tjetër.

Këto Dokumentet e Procedurës Konkurruese përbëjnë një ftesë për të paraqitur Ofertë. Ato nuk përbëjnë kërkesë për investim apo për pjesëmarrjen në Projekt.

PËRKUFIZIME

APP	është Agjencia e Prokurimit Publik e Republikës së Shqipërisë.
Përfaqësues i Autorizuar	është përfaqësuesi i Ofertuesit (ose në rastin e një Bashkimi të Shoqërive, përfaqësuesi i autorizuar i Bashkimit të Shoqërive) i autorizuar për të nënshkruar Ofertën në bazë të prokurës në formën e Shtojcës 22 (<i>Prokura</i>).
Oferta	është Oferta e paraqitur në përputhje me këto Dokumente të Procedurës Konkurruese.
Komisioni i Vlerësimit të Ofertave	është komisioni i ngritur nga Autoriteti Kontraktues për të administruar Procedurën Konkurruese në emër të Autoritetit Kontraktues, me anë të Urdhrit të Ministrit nr. [të plotësohet nga MSH] datë [të plotësohet nga MSH].
Ofertues	është ofertuesi që do të paraqesë një Ofertë në përputhje me këto Dokumente të Procedurës Konkurruese.
Sigurimi i Ofertës	është garancia bankare e ofruar nga Ofertuesi për të garantuar pajtueshmërinë e Ofertuesit me Ofertën e bërë prej tij, e cila është kryesisht në formën e Shtojcës 3 (<i>Formulari i Sigurimit të Ofertës</i>)
Procedura Konkurruese	është procedura konkurruese e përcaktuar në Dokumentet e Procedurës Konkurruese.
Dokumentet e Procedurës Konkurruese	është ky dokument i procedurës konkurruese bashkë me shtojcat e tij.
Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës	është periudha e specifikuar në paragrafin 1.13të këtyre Dokumenteve të Procedurës Konkurruese.
Periudha e Vlefshmërisë së Sigurimit të Ofertës	është periudha që përfundon pas [30] ditëve kalendarike nga Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës.
Kontrata e Koncesionit	është kontrata e koncesionit që do të lidhet midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit, një draft i të cilës gjendet bashkëngjitur si Shtojca 17 (<i>Draft Kontrata e Koncesionit</i>).
Koncesionari	është shoqëria për qëllime të veçanta e krijuar nga Ofertuesi Fitues për të nënshkruar Kontratën e Koncesionit në vijim të Procedurës Konkurruese dhe për të marrë përsipër Projektin.
Bashkim Shoqërish	ka kuptimin që i jepet në paragrafin 13.6.1 të këtyre Dokumenteve të Procedurës Konkurruese.
Personi i Kontaktit	është personi i identifikuar në paragrafin 1.1të këtyre Dokumenteve të Procedurës Konkurruese.
Sigurimi i Kontratës	është sigurimi i kontratës që kërkohet në përputhje me paragrafin 4.4.4 të këtyre Dokumenteve të

	Procedurës Konkurruese, kryesisht në formën e parashikuar në Kontratën e Koncesionit.
Autoriteti Kontraktues	është MSH.
Oferta Financiare	është oferta financiare e paraqitur nga një Ofertues si pjesë e Ofertës.
Fondi i Sigurimit Shëndetësor	është Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
Spitale	janë spitalet në nivel bashkie, spitalet e qarkut dhe spitalet e terciare të përfshira në Projekt, sipas listës në Shtojcën 23 (<i>Listae Spitaleve</i>)
Koordinatori i IFC	është koordinatori i IFC i identifikuar në paragrafin 1.1 të këtyre Dokumenteve të Procedurës Konkurruese.
Anëtari Kryesues	ka kuptimin që i jepet në paragrafin 3.16.2 të këtyre Dokumenteve të Procedurës Konkurruese.
Ofertuesi i Skualifikuar	është Ofertuesi i përshkruar në paragrafin 8.3.5 të këtyre Dokumenteve të Procedurës Konkurruese.
Person	është një person fizik ose një Shoqëri.
Ligji i PPP	është ligji nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe nga APP për dhënien me koncesion sipas Ligjit të APP.
Ofertuesi i Preferuar	ka kuptimin që i jepet në paragrafin 9.3.3 të këtyre Dokumenteve të Procedurës Konkurruese.
Projekti	është financimi, projektimi, rinovimi, zotërimi, administrimi, funksionimi, mirëmbajtja dhe transferimi i laboratorëve të rinj në Spitale, në formën e partneritetit publik privat midis Koncesionarit dhe Autoritetit Kontraktues.
Ligji i Prokurimit Publik	është ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe nga APP në lidhje me procedurat e prokurimit publik.
Ofertues i/të Kualifikuar	janë Ofertuesit që plotësojnë Kriteret e Kualifikimit dhe kualifikohen për vlerësimin e mëtejshëm të Ofertave të tyre nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, sipas Dokumenteve të Kualifikimit.
Kriteret e Kualifikimit	janë kriteret e përcaktuara në Shtojcën 9 (<i>Kritere e Kualifikimit</i>) dhe Shtojcën 9/1.
Dokumentet e Kualifikimit	janë dokumentet dhe informacionet që duhet të dorëzohen nga Ofertuesit në përputhje me paragrafin 8.2 të këtyre Dokumenteve të Procedurës Konkurruese, në mënyrë që të kualifikohen për vlerësimin e Ofertës Teknike dhe Financiare.
Ofertuesi Fitues	është Ofertuesi Fitues me të cilin do të lidhet Kontrata e Koncesionit, si rrjedhojë e arritjes së rezultatit më të lartë në vlerësimin e Ofertave.

Formulari i Njoftimit të Ofertuesit Fitues	është njoftimi në formën e Shtojcës 16 (<i>Formulari i Njoftimit të Ofertuesit Fitues</i>).
Afati i Dorëzimit	është ora dhe data e përcaktuar në paragrafin 1.1 të këtyre Dokumenteve të Procedurës Konkurruese.
Oferta Teknike	janë dokumentet që përmbajnë seksionin teknik të Ofertës të dorëzuar nga Ofertuesi si pjesë e Ofertës së tij.
Specifikimet Teknike	janë kërkesat teknike në lidhje me Projektin, të përcaktuara në Shtojcën 13 (<i>Specifikimet Teknike</i>).
Data Room-i Virtual	është faqja e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik (“APP”).

1 NJOFTIMI I KONTRATËS

1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues: Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Shqipërisë
Adresa: Bulevardi "Bajram Curri" Nr. 1, Tiranë, Shqipëri
Tel/Faks: +355 4 2376178
Personi i Kontaktit: Z. Raimond Cimbi
Drejtor i Drejtorise se Prokurimeve, Investimeve dhe Koncesioneve
Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Shqipërisë
Bulevardi "Bajram Curri" Nr. 1, Tiranë, Shqipëri
Email: Raimond.Cimbi@shendetesia.gov.al

Faqja e internetit: www.shendetesia.gov.al

Çdo komunikim, pyetje ose kërkesë për informacion nga Ofertuesit, në lidhje me Procedurën e Konkurruese, do t'i drejtohet Personit të Kontaktit.

1.2 Lloji i Autoritetit Kontraktues dhe objekti i aktivitetit të tij ose aktivitetet kryesore

Institucion Qendror

1.3 Objekti i Kontratës së Koncesionit

Shërbime

1.4 Përmbledhje e kushteve kryesore të Kontratës së Koncesionit

Objekti i Kontratës: Financimi, projektimi, rinovimi, pajisja, riorganizimi dhe funksionimi i rrjetit të laboratorëve publik në Spitale, të përcaktuar në Shtojcën 23, për kryerjen e analizave laboratorike të renditura në listën e Shtojcës 14.

Forma e Kontratës: Partneritet publik privat për shërbime publike

Burimi i Financimit të Projektit: Buxheti i shtetit nëpërmjet Spitaleve subjekt i kësaj kontrate.

Tarifa e koncesionit që do të paguhet nga Koncesionari: asnjë.

1.5 Afati i Kontratës së Koncesionit

10 vjet duke filluar nga Data e Vënies në Funkcion (e përcaktuar në Kontratën e Koncesionit).

1.6 Vendndodhja e Objektivit të Kontratës

Spitalet e renditura në Shtojcën 23.

1.7 Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik (Dokumentet e Kualifikimit)

Sipas Seksionit 8 të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese.

Vetëm Ofertat e Ofertuesve të Kualifikuar do të vlerësohen nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

1.8 Sigurimi i Ofertës

Në momentin e Afatit të Dorëzimit, Ofertuesit paraqesin Sigurimin e Ofertës (pra 2% e vlerës së përllogaritur të Projektit, të përcaktuar në paragrafin 1.17.) në shumën 260,119,320 ALL

(dyqind e gjashtëdhjetë milion njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e treqind e njëzet) e cila mund të konvertohet në Euro duke përdorur kursin e këmbimit ALL – EUR të publikuar nga Banka e Shqipërisë në datën e publikimit të njoftimit të kontratës.

1.9 Procedura Konkurruese

E hapur

1.10 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit

Ofertuesi fitues përzgjidhet ndër Ofertuesit e Kualifikuar, sipas kriterëve të vlerësimit dhe metodologjisë së vendosjes së pikëve, të përcaktuar në Shtojcën 11 (*Kriteret e vlerësimit dhe Metodologjia e Vendosjes së Pikëve*).

Ofertuesi paraqet një Propozim Teknik, siç përcaktohet në Shtojcën 26 (*Formulari i Ofertës Teknike*) dhe ofron një Zbritje Uniformë në Përqindje (me tre shifra pas presjes dhjetore) për tarifën e analizave laboratorike të përcaktuara në Shtojcën 1 (*Formulari i Ofertës Financiare*). Tabela e pikëve është si më poshtë:

Kriteri #	Përshkrimi	Pikë (pikët maksimale)
1	Rrjeti laboratorik bashkëqendror (<i>hub and spoke</i>), dhe Sistemi i Informacionit Laboratorik dhe Sistemi logjistikës	10
2	Plani i Zbatimit të Projektit dhe Riinvestimi	15
3	Burimet Njerëzore dhe Plani i Trajnimit	10
4	Planin i Objekteve dhe Pajisjeve, qasja e mirëmbajtjes dhe strategjia e zëvendësimit gjatë afatit të kontratës	10
5	Plani i menaxhimit të cilësisë dhe metodologjia për kryerjen e analizave	15
	TOTALI	60

Pikët për ofertën financiare

Oferta financiare vlerësohet deri në 40 pikë, ku zbritja më e madhe e çmimit për testet merr pikët maksimale.

Pikët përfundimtare

Rezultati i pikëve të ofertës teknike i shtohet pikëve të ofertës financiare nga ku del rezultati i pikëve totale, deri në 100 pikë.

1.11 Afati i Dorëzimit

Data: 15 shkurt 2017

Ora: 15:00 Ora e Evropës Qendrore

Vendi www.app.gov.al

Ofertuesit duhet të dorëzojnë ofertat në gjuhën shqipe ose në gjuhën angleze, të shoqëruar me përkthimin zyrtar në shqip, në mënyrë elektronike, duke e ngarkuar atë, përpara Afatit të Dorëzimit, në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, www.app.gov.al.

Udhëzimet në shqip dhe anglisht për ngarkimin e Ofertës në faqen zyrtare të internetit gjenden në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, www.app.gov.al.

1.12 Hapja e Ofertave

Datë: 15 shkurt 2017

Ora: 15:00 Ora e Evropës Qendrore

Vendi www.app.gov.al

1.13 Periudha e Vlefshmërisë së Ofertave

Çdo Ofertë është e vlefshme për një periudhë prej 150 ditë nga Afati i Dorëzimit (“**Periudha e Vlefshmërisë së Ofertave**”).

Oferta e Ofertuesit Fitues do të jetë e vlefshme deri në Datën e Nënshkrimit të Kontratës dhe Autoriteti Kontraktues do të mund të kërkojë që Oferta e një Ofertuesi të Kualifikuar të pasuksesshëm të shtyhet deri në Datën e Nënshkrimit të Kontratës.

1.14 Gjuha

Përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe në këto Dokumente të Procedurës Konkurruese, gjuha e Ofertave do të jetë gjuha Shqip. Dokumentet e Procedurës Konkurruese publikohen në gjuhën shqipe dhe angleze, në rast mospërputhje apo paqartësie, ka përparësi gjuha shqipe.

1.15 Kostot

Dokumentet e Procedurës Konkurruese mund të shkarkohen elektronikisht, pa pagesë, nga faqja zyrtare e APP-së, www.app.gov.al.

Çdo Ofertues përballon kostot dhe shpenzimet që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e Ofertës së tij. Gjithashtu, shpenzimet për koston e Dokumenteve të Procedurës Konkurruese, për sa i përket përgatitjes së dokumentacionit dhe shërbimeve të specializuara të këshillimit për transaksionin, në vlerën e 600,000 EUR (gjashtëqind mijë EUR) do të mbulohen nga Ofertuesi i Fitues dhe do t’i paguhet direkt IFC-së, në përputhje me dispozitat e Kontratës së Koncesionit.

Koncesionari do të rimbursojë edhe kostot e Autoritetit Kontraktues në lidhje me shpalljen e njoftimit të kontratës, në vlerën 357,330 lekë brenda 30 ditëve kalendarike nga marrja e Formularit të Njoftimit të Ofertuesit Fitues.

Referuar pikës 7-të VKM-se nr.150, datë 22.03.2007, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve“, ofertuesi fitues përpara nënshkrimit të kontratës duhet të paguaje tarifën prej 30,000 euro.

1.16 Tarifa e ankimit

Tarifa për tu paguar nga Ofertuesi për dorëzimin e një ankimi përpara Komisionit të Prokurimit Publik është e barabartë me 26,011,932 ALL (njëzet e gjashtë milion e njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e dy) që përfaqëson 10% të Sigurimit të Ofertës.

1.17 Vlera e Kontratës (Projektit) llogaritur bazuar në mbështetjen financiare të parashikuar për gjithë kohëzgjatjen e kontratës.

13,005,966,000 ALL (trembëdhjetë miliardë e pesë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) (pa TVSH)¹

¹Ky numër përfaqëson vlerën e parashikuar të Projektit pa TVSH

1.18 Monedha

Ofertuesi do të paraqesë ofertën e tij në monedhën Lekë (ALL).

1.19 Data e Shpalljes së Njoftimit të Kontratës

22 dhjetor 2016

UDHËZIME PËR OFERTUESIT – DOKUMENTET E PROCEDURËS KONKURRUESE

2 HYRJE

Ministria e Shëndetësisë ka vendosur të implementojë projektin për Koncesionin/Partneritetin Publik Privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale, dhe atyre bashkiake të Sarandës e Lushnjës. Përzgjedhja e Ofertuesit Fitues do të bëhet në bazë të një procedure konkurruese (të hapur) sipas kritereve kualifikuese dhe vlerësuese të specifikuara në këtë dokument. Kohëzgjatja e kontratës Koncesionare/PPP: 10 vjet nga hyrja në fuqi e saj. Ndaj ftohen Ofertuesit të paraqesin Ofertën që përmbush kërkesat e këtyre Dokumenteve të Procedurës Konkurruese.

Ofertuesit do të plotësojnë Shtojcat përkatëse të bashkëngjitura në këto Dokumente të Procedurës Konkurruese. Shtojcat me shënimin “NUK ËSHTË E ZBATUESHME” nuk do të konsiderohen nga Ofertuesit për përgatitjen e Ofertave.

2.1 Informacion i mëtejshëm lidhur me objektin

Projekti i synuar do të përfshijë një procedurë PPP gjatë së cilës një operator ekonomik do të shpallet fituesi i Kontratës së Koncesionit për projektimin ose ri projektimin, ndërtimin ose rindërtimin, pajisjen, funksionimin dhe mirëmbajtjen e shërbimit laboratorik në disa spitale të sektorit shëndetësor publik në Shqipëri, për një periudhë të caktuar kohore (“Projekti”).

Objektivi i këtij projekti është të përmirësojë shërbimin laboratorik publik në Shqipëri, duke tërhequr një partner privat për të strukturuar dhe operuar një rrjet me një nivel të laboratorëve publikë, për të investuar në infrastrukturën laboratorike dhe në teknologjinë e informacionit, për të ngritur një sistem të menaxhimit të cilësisë, duke propozuar çmime të barasvlershme me ato të homologëve në rajon.

Një rrjet laboratorësh në ambientet e spitaleve publike, përfshin një laborator qendror në Tiranë, 6 laboratorë standard qarku dhe 11 laboratorë urgjence në spitale. Kombinimi përfundimtar i laboratorëve dhe i vendndodhjes së tyre i lihet në dorë ofertuesit, që ta sugjerojë si pjesë të Ofertës së tij.

Parashikohet modeli i të ashtuquajturit rrjet me një nivel. Ai synohet të optimizojë shërbimin ndaj pacientëve, të rrisë aksesin në shërbime laboratorike të cilësisë së parë dhe të grupojë burimet për të ulur nivelin e investimit të nevojshëm për t’i shërbyer popullsisë.

Në praktikë kjo do të thotë që:

- Një paketë laboratorike për analizat urgjente do të mbetet e disponueshme në të gjitha spitalet. Kjo paketë përfshin analizat laboratorike që duhet të kryhen brenda një harku të shkurtër kohor, ndaj nuk mund të çohen në laboratorin qendror;
- Një paketë analizash standarde/të ndërmjetme, përfshirë analizat urgjente, do të ofrohet në laboratorët standard spitalor që ndodhen në rrethet kryesore;
- Pjesa tjetër, analizat e specializuara dhe të sofistikuara të listës së referencës të analizave laboratorike do të bëhen në një laborator qendror.

Ofertat pritet të plotësojnë ose të tejkalojnë standardet minimale të përcaktuara në Shtojcën 13 Specifikimet Teknike të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese dhe në shtojcat e Kontratës së Koncesionit, bashkëngjitur Dokumenteve të Procedurës Konkurruese, në Shtojcën 17.

2.1.1 Informacion më i detajuar rreth Projektet jepet në Shtojcën 14 (*Termtat e Referencës së Projektit*) dhe në Data Room-in Virtual.

2.2 Objektivi i Koncesionit

Objektivi i Koncesionit është të përmirësojë shërbimet laboratorike spitalore duke ngritur një rrjet të laboratorëve publik, që garanton konsistencë dhe besueshmëri në shërbimin laboratorik të ofruar në Spitale për analizat laboratorike mjekësore, të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues në Shtojcën 14.

Projekti është në përputhje me objektivat e reformës të MSH, në mënyrë që:

- Të rritet aksesimi në shërbimet e shëndetit publik;
- Të rritet cilësia e ofrimit të shërbimit të shëndetit publik;
- Të reduktohen shpenzime shëndetësore të pacientëve; dhe
- Të përmirësohet administrimi i sistemit të shëndetit publik.

2.3 Veprimtaritë që do të kryhen nga Koncesionari

Rinovimi, projektimi, rehabilitimi dhe funksionimi i laboratorëve në Spitalet e përcaktuar në Shtojcën 23 Lista e Spitaleve, në bazë të specifikimeve teknike të Autoritetit Kontraktues, të përcaktuara në Shtojcën 13; Pajisja e Laboratorëve për kryerjen e analizave laboratorike të specifikuara në Shtojcën 14; Ngritja e rrjetit dhe e logjistikës përkatëse; Mirëmbajtja e pajisjeve të laboratorëve; Punësimi dhe trajnimi i stafit; Ngritja e sistemeve të menaxhimit të cilësisë dhe e sistemit të informacionit të laboratorit; kryerja e analizave të listës së përshkruar në Shtojcën 14; Funksionim i plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës së Koncesionit.

2.4 Informacioni dhe të dhënat e Projektit

2.4.1 Autoriteti Kontraktues do të vendosë në dispozicion në website të APP , të dhënat e mëposhtme:

- a. Memorandumi i Informacionit
- b. Planimetritë e Laboratorëve
- c. Numrin e analizave për spital universitar/rajonale
- d. Informacion mbi stafin aktual të laboratorëve
- e. Numri i pacientëve të shtruar në spital/të jashtëm për spital, duke përfshirë kapacitetin e shtretërve

2.4.2 Përlllogaritjet aktuale paraprake të vëllimit total të investimit të ri kapital, duke përfshirë shpenzimin kapital kryesor të mirëmbajtjes dhe të zëvendësimit, që varjon në CAPEX i përgjithshëm për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës: 10.3 milion euro (pa TVSH)

2.5 Ligji i zbatueshëm

Procesi i tenderit do të rregullohet nga Ligji 125/2013 “Për koncesionet dhe PPP”, i ndryshuar, dhe Ligji 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimit Publik në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar për aq sa përcaktohet në ligjin e Koncesioneve/PPP.

3 PROCEDURA KONKURRUESE

3.1 Sqarime të pyetjeve dhe Ndryshime

3.1.1 Çdo Ofertues që kërkon sqarime mbi këto Dokumente të Procedurës Konkurruese mund të dërgojë kërkesë për sqarim, jo më vonë se datat përkatëse të cilësuar në Kalendarin e Parashikuar në Shtojcën 24 (*Kalendari i Parashikuar*) (për dorëzimin e

kërkesave për sqarim), elektronikisht, duke i ngarkuar në faqen zyrtare të APP dhe duke i dërguar një kopje me email²

- 3.1.2 Përgjigjja ndaj këtyre kërkesave për sqarim, duke përfshirë një shpjegim të pyetjes por pa identifikuar burimin e saj, do të postohet për të gjithë Ofertuesit në faqen zyrtare të APP-së brenda 3 (tre ditëve) nga marrja e kërkesës. MSH mund të zgjedhë të japë një përgjigje të vetme ndaj një grupi kërkesash të ngjashme.
- 3.1.3 Një Ofertues mund të propozojë ndryshime dhe/ose korrigjime në këto Dokumente të Procedurës Konkurruese të postuara në faqen zyrtare të APP-së [duke i dërguar një kopje me e-mail Personit të Kontaktit , së bashku me një shënim të veçantë, ku shpjegohen arsyet për çdo ndryshim dhe/ose korrigjim. Për të shmangur dyshimet, ndryshimet/korrigjimet në Kontratën e Koncesionit mund të propozohen në përputhje me paragrafin 3.3.
- 3.1.4 Pa cenuar nenin 3.3 më poshtë, ndryshimet/korrigjimet e këtyre Dokumenteve të Procedurës Konkurruese, të propozuara nga Ofertuesit, ngarkohen në faqen zyrtare të APP-së dhe dërgohen elektronikisht, me e-mail, te Personi i Kontaktit , jo më vonë se [10 ditë nga publikimi i këtyre Dokumenteve të Procedurës Konkurruese]. MSH rezervon të drejtën të mos i pranojë ndryshimet e propozuara të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese, si dhe të refuzojë ndryshimet e propozuara të paraqitura pas datës së përcaktuar në Kalendarin e Parashikuar.
- 3.1.5 E drejta e Ofertuesve për të ndryshuar Dokumentet e Procedurës Konkurruese, në përputhje me pikat 3.1.3 dhe 3.1.4 nuk interpretohet si e drejtë e Ofertuesit për të kundërshtuar këto Dokumente të Procedurës Konkurruese. Nëse Ofertuesi dëshiron të ankohet për Dokumentet e Procedurës Konkurruese, zbatohen sipas rastit dispozitat dhe kushtet e Ligjit tëPPP. Për të shmangur dyshimet, e drejta e Ofertuesve për të ndryshuar Dokumentet e Procedurës Konkurruese dhe/ose për të propozuar ndryshime në Kontratën e Koncesionit, në përputhje me paragrafin 3.3 më poshtë, nuk interpretohet si e drejtë e Ofertuesve për të dorëzuar Oferta që kushtëzohen nga pranimi i këtyre ndryshimeve.
- 3.1.6 Versionet e ndryshuara të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese, nëse ndryshohen, do të vihen në dispozicion të gjithë Ofertuesve në faqen zyrtare të APP-së, përpara Afatit të Dorëzimit, dhe në këtë rast ato do të jenë përfundimtare për Ofertuesit. Në vijim, asnjë komunikim, i çfarëdolloj natyre, përfshirë pa kufizim përgjigjet ndaj për pyetjet apo kërkesat për sqarim, nuk do të konsiderohet se përbën ndryshim të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese.
- 3.1.7 Autoriteti Kontraktues mund të ndryshojë me iniciativën e tij, në çdo kohë dhe për çdo arsye, këto Dokumente të Procedurës Konkurruese dhe Kontratën e Koncesionit (duke përfshirë Shtojcat dhe Anekset). Versionet e ndryshuara do t'i komunikohen të gjithë Ofertuesve nëpërmjet faqes së internetit të APP-së dhe do të konsiderohen si Dokumentet përfundimtare të Procedurës Konkurruese për këtë Procedurë përzgjedhëse Konkurruese. Në këtë rast, Autoriteti Kontraktues mund, me iniciativën e tij, të zgjasë Afatin e Dorëzimit dhe të publikojë Afatin e ri të Dorëzimit në përputhje me ligjin për PPP.

²Çdo kërkesë për sqarim ose ndryshim dërguar nga Ofertuesit me e-mail konform këtij paragrafi duhet të dërgohet njëkohësisht me postë në adresën e Autoritetit Kontraktues e përcaktuar në paragrafin 1.1 në vëmendje të Personit të Kontaktit.

3.2 Kalendari i Parashikuar

- 3.2.1 Kalendari i Parashikuar i Procedurës Konkurruese jepet i detajuar në Shtojcën 24 (*Kalendari i Parashikuar*).
- 3.2.2 MSH mund të ndryshojë Kalendarin e Parashikuar sipas gjykimit të saj të vetëm. Në këtë rast, MSH njofton menjëherë Ofertuesit për ndryshimet e bëra në Kalendarin e Parashikuar.

3.3 Konferenca e Ofertuesve

- 3.3.1 MSH do të organizojë konferencën e Ofertuesve në datën e specifikuar në Kalendarin e Parashikuar, për të prezantuar Projektin dhe për të diskutuar për çdo koment që mund të bëjnë Ofertuesit në lidhje me Projektin, me Dokumentet e Procedurës Konkurruese ose me Kontratën e Koncesionit. Ftohen Ofertuesit të konfirmojnë pjesëmarrjen në konferencën e Ofertuesve, përmes Personit të kontaktit të IFC, me anë të emailit kbachongy@ifc.org.
- 3.3.2 Jo më vonë se data e përcaktuar në Kalendarin e Parashikuar, Ofertuesit ftohen të dërgojnë ndryshimet e propozuara prej tyre të Kontratës së Koncesionit, duke i bërë direkt ato, në mënyrë të dallueshme (me *track changes*), në Kontratën e Koncesionit (në format word) të postuar në faqen zyrtare të APP-së, së bashku me një tabelë të veçantë në formën e mëposhtme, ku shpjegohen arsyet për ndryshimin dhe/ose korrigjimet e propozuara. Ndryshimet e Kontratës së Koncesionit të propozuara nga Ofertuesit do të ngarkohen në faqen e internetit të APP-së dhe i dërgohen elektronikisht, me email, Personit të Kontaktit. MSH rezervon të drejtën të mos pranojë ndryshimet e propozuara të Kontratës së Koncesionit dhe të refuzojë ndryshimet e propozuara të paraqitura më vonë se data e përmendur më sipër. Seksioni 3.1.6 zbatohet përkatësisht edhe për ndryshimet e propozuara të Kontratës së Koncesionit.

Forma e tabelës me ndryshimet e propozuara të Kontratës së Koncesionit

Komenti nr.	Pika e ndryshuar (shtime/fshirje)	Shpjegim i detajuar i arsyeve për ndryshimin e propozuar	Shpjegim i detajuar i ndikimit që do të kishte në ofertë pranimit apo mospranimit të ndryshimit nga MSH
1			
2			
3			

3.4 Vizitat në terren

MSH do të organizojë vizita në terren në datën e përcaktuar në Kalendarin e Parashikuar. Orari i vizitave do të publikohet në kalendarin bashkëlidhur. MSH mund të organizojë edhe vizita të tjera sipas gjykimit të saj. Pjesëmarrja e Ofertuesve gjatë vizitave në terren, bëhet me koston, riskun dhe nën përgjegjësinë e vet atyre.

3.5 Informacione në formë elektronike

Ofertuesit kanë akses në informacionin në formë elektronike, në faqen www.app.gov.al duke filluar nga data publikimit të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese.

3.6 Kërkimet dhe studimet e Ofertuesve

Çdo Ofertues do të jetë vetë përgjegjës për të kryer kërkimin e tij të pavarur, due diligence-ën dhe çdo punë ose hetim tjetër dhe për të kërkuar konsulencën e pavarur të nevojshme apo të dëshirueshme për përgatitjen e Ofertës së tij.

3.7 Konfidencialiteti i Ofertës

3.7.1 Çdo material, dokument, akt ose deklaratë me shkrim që përmban informacione, do të konsiderohet si konfidencial sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë:

- për nga natyra është konfidencial;
- është vendosur të mbetet konfidencial.

3.7.2 Ofertuesit duhet të identifikojnë qartë çdo dokument ose informacion që ata dëshirojnë të mbetet konfidencial, duke plotësuar formularin e dhënë në Shtojcën 4 (*Lista e Informacionit Konfidencial*)

3.7.3 Nëse nuk parashikohet me ligj, vendim gjykate ose nga Dokumentet e Procedurës Konkurruese, asnjëra nga palët nuk mund të nxjerrë informacionin teknik, informacionin për çmimet ose ndonjë informacion tjetër në lidhje me Procedurën Konkurruese, pa marrë miratim paraprak.

3.7.4 Autoriteti Kontraktues nuk konsiderohet se ka shkelur detyrimet e ruajtjes së konfidencialitetit që ka ndaj një Ofertuesi, në rastin kur:

- Autoriteti Kontraktues jep të dhënat punëmarrësve, konsulentëve ose nën Kontraktuesëve vetëm në lidhje me Procedurën e Konkurrimit ose për t'u përgatitur për një kontratë apo për ta administruar atë kontratë;
- Informacioni i jepet personelit të Autoritetit Kontraktues për të bërë të mundur administrimin dhe kontrollin efektiv të Procedurës Konkurruese;
- Informacioni nxirret nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për mundësuat vlerësimin e Ofertave;
- Informacioni jepet nga Autoriteti Kontraktues në përgjigje të një kërkesë nga një komision i Parlamentit të Shqipërisë;
- Informacioni jepet nga Autoriteti Kontraktues brenda Qeverisë së Shqipërisë ose te një Departament apo Agjenci tjetër Qeveritare, në përputhje me interesin legjitim të Qeverisë së Shqipërisë dhe të Autoritetit Kontraktues;
- Informacioni kërkohet të jepet sipas legjislacionit.

3.8 Konfidencialiteti i informacionit të Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë që i gjithë informacioni shkresor (qoftë ose jo konfidencial dhe pavarësisht mënyrës në të cilën iu është dhënë Ofertuesve) që u është dhënë Ofertuesve:

- T'i rikthehet Autoritetit Kontraktues – në këtë rast, i gjithë informacioni kthehet menjëherë nga Ofertuesi në adresën e cilësuar nga Autoriteti Kontraktues; ose
- Të shkatërrohet nga Ofertuesi – në këtë rast, Ofertuesit duhet të shkatërrojë menjëherë të gjithë informacionin dhe t'i japin Autoritetit Kontraktues dëshmi me shkrim se e ka shkatërruar informacionin.

3.9 Përdorimi i dokumenteve të Ofertave

3.9.1 Të gjitha Ofertat bëhen pronë e Autoritetit Kontraktues.

3.9.2 Pavarësisht nga sa më sipër dhe pa cenuar ndonjë marrëveshje vijuese të lidhur midis Autoritetit Kontraktues dhe çdo Ofertuesi, zotërimi i të drejtave të pronësisë intelektuale, në lidhje me informacionin e dhënë në Ofertë mbetet i pandryshuar.

3.9.3 Autoriteti Kontraktues mund të përdorë të dhënat e një propozimi ose të dhënat e ofruara nga një Ofertues për qëllime të Procedurës Konkurruese (përfshirë përgatitjen ose administrimin e çdo kontrate ose marrëveshjeje).

3.9.4 Autoriteti Kontraktues i trajton Ofertuesit në mënyrë të barabartë gjatë Procedurës Konkurruese, duke respektuar konfidencialitetin e informacionit të dhënë prej tyre.

3.10 Shpërndarja e informacionit

Ofertuesi nuk bën asnjë deklaratë apo nuk nxjerr asnjë dokument apo material, e as nuk jep asnjë informacion për publikim në asnjë media, në lidhje me Procedurën Konkurruese, vlerësimin e Ofertave, pranimin e ndonjë Oferte, zhvillimin e negociatave apo njoftimin e caktimit të Ofertuesit Fitues, pa miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

3.11 Të drejta shtesë të Autoritetit Kontraktues

3.11.1 Pa kufizuar të drejtat e tjera që ka gjatë Procedurës Konkurruese, Autoriteti Kontraktues mundet që në çdo kohë, përpara dorëzimit të Ofertës dhe pa dhënë asnjë arsye:

- T'u japë informacione dhe sqarime shtesë të gjithë Ofertuesve;
- Të kërkojë informacion të mëtejshëm nga çdo Ofertues lidhur me Ofertën e tij
- Të kërkojë sqarime nga çdo Ofertues;
- T'i përgjigjet çdo pyetjeje që i është drejtuar Autoritetit Kontraktues për sqarim, nga Ofertuesit, dhe të publikojë pyetjen dhe përgjigjen në faqen zyrtare të APP-së;
- Të përsërisë, të pezullojë, të ribëjë ose të përfundojë Procedurën Konkurruese sipas shkaqeve të përcaktuara në legjislacionin përkatës.

3.11.2 Ofertuesit nuk kanë të drejtë të ngrenë pretendime ndaj MSH, Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, Qeverisë Shqiptare apo nëpunësve, Kontraktuesëve, punëmarrësve, agjentëve ose këshilltarëve të tyre, në lidhje me ushtrimin ose mosushtrimin e të drejtave të përcaktuara në këtë paragraf 3.11.

3.12 Informacioni i rremë

Çdo Ofertues që jep informacion të rremë mund të përjashtohet nga Procedura Konkurruese në çdo kohë. Nëse dhënia e informacionit të rremë konstatohet pas nënshkrimit të Kontratës së Koncesionit, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të zgjidhë Kontratën e Koncesionit në përputhje me kushtet e saj. Ofertuesit duhet të përdorin këto Dokumente të Procedurës Konkurruese pa i bërë ndryshim përmbajtjes së tyre. Sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, dhënia e informacioneve të rreme, përpilimi i dokumenteve të rreme apo te falsifikuara si dhe çdo deklaratë apo ndonjë e dhënë tjetër që nuk pasqyron të vërtetën, konsiderohet veprë penale.

3.13 Konflikti i interesit

Rastet e konfliktit të interesit do të trajtohen në përputhje me ligjin 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar dhe akteve nënligjore nënligjore në zbatim të tij. Veprimet e kundraligjshme

3.14 Veprimet e Kundraligjshme

Në përputhje me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit dhe etikën në administratën publike, Autoriteti Kontraktues e refuzon një Ofertë, nëse Ofertuesi që e ka paraqitur atë:

- i ka dhënë ose përgatitet t’i japë një punonjësi aktual apo të mëparshëm të Autoritetit Kontraktues, një dhuratë në para ose në forma të tjera, si një përpjekje për të ndikuar një veprim ose vendim në rrjedhën e Procedurës Konkurruese;
- ka një konflikt interesi ose mosmarrëveshje të pazgjidhur në lidhje me Procedurën Konkurruese; ose
- ka dorëzuar dokumente/informacione të rreme që lidhen me kërkesat e paraqitura në Dokumentet e Procedurës Konkurruese.

3.14.1 Asnjë Ofertues (duke përfshirë agjentët dhe përfaqësuesit) nuk duhet të kontaktojë apo të tentojë të kontaktojë anëtarët e Autoritetit Kontraktues, apo anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, apo anëtarë apo punonjës të Qeverisë së Shqipërisë ose të departamenteve, ministrive, agjencive apo organeve ekzekutive të saj, në lidhje me Procedurën Konkurruese, përveçse sipas procedurës së përcaktuar në Dokumentet e Procedurës Konkurruese.

3.14.2 Autoriteti Kontraktues do të njoftojë me shkrim Ofertuesit dhe çdo institucion të Qeverisë së Shqipërisë, për çdo veprim të kundraligjshëm të ofertuesit dhe bën shënimin përkatës në raportin për Procedurën Konkurruese.

3.15 Shpenzimet

3.15.1 Çdo Ofertues përballon shpenzimet e veta në lidhje me përgatitjen dhe dorëzimin e Ofertës së tij.

3.15.2 Gjithashtu, shpenzimet për koston e Procedurës Konkurruese, për sa i përket përgatitjes së dokumentacionit dhe shërbimeve të specializuara të këshillimit në vlerën e 600,000

Euro (gjashtë mijë euro) do të mbulohen nga Ofertuesi Fitues dhe do t'i paguhen direkt IFC-së, në përputhje me dispozitat e Kontratës së Koncesionit.

- 3.15.3 Koncesionari do të rimbursojë edhe kostot e Autoritetit Kontraktues në lidhje me shpalljen e njoftimit të kontratës, në vlerën e 357,330 (treqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e treqind e tridhjetë) Lekë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga marrja e Formularit të Njoftimit të Ofertuesit Fitues (Shtojca16).

Referuar pikës 7-të VKM-se nr.150, datë 22.03.2007, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve", ofertuesi fitues përpara nënshkrimit të kontratës duhet të paguaje tarifën 30,000 (tridhjetë mijë) Euro.

3.16 Bashkimi i Shoqërive

- 3.16.1 Një Ofertues mund të marrë formën e një bashkimi shoqërisht ("**Bashkim Shoqërisht**") të përbërë nga shoqëri, firma, korporata apo persona të tjerë juridikë.
- 3.16.2 Çdo Bashkim Shoqërisht duhet të caktojë dhe të autorizojë një anëtar kryesues ("**Anëtari Kryesues**") për të përfaqësuar dhe për t'u zotuar në mënyrë të pakthyeshme për të gjithë anëtarët e Bashkimit të Shoqërive, në të gjitha çështjet lidhur me Procedurën Konkurruese.
- 3.16.3 Asnjë person nuk mund të marrë pjesë në dy ose më shumë Oferta, qoftë individualisht apo si anëtar i një Bashkimi Shoqërisht.
- 3.16.4 Asnjë Ofertues apo anëtar i një Bashkimi Shoqërisht nuk mund të ushtrojë kontrolle mbi një Ofertues tjetër apo mbi një anëtar të një Bashkimi Shoqërisht. Për qëllime të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese, "kontroll" nënkupton kompetencën për të zgjedhur shumicën e anëtarëve të bordit drejtues (ose të një organi tjetër të ngjashëm) ose për të drejtuar administrimin dhe politikën e një subjekti, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, qoftë përmes zotërimit të drejtave të votës, sipas kontratës ose ndryshe, dhe "kontrollues" dhe "i kontrolluar" kanë kuptime të lidhura reciprokisht.

3.17 Pajtimi me Dokumentet e Procedurës Konkurruese

Çdo Ofertues duhet të marrë në konsideratë udhëzimet, kriteret, kushtet, specifikimet, afatet dhe të gjithë informacionin në Dokumentet e Procedurës Konkurruese. Në rast se Ofertuesi:

- i) nuk plotëson të gjithë dokumentacionin dhe informacionin në Dokumentet e Procedurës Konkurruese; ose
- ii) paraqet një ofertë e cila nuk është në përputhje me kushtet dhe kërkesat e Dokumenteve të Procedurës Konkurruese.

Autoriteti Kontraktues do të përcaktojë se oferta nuk është në përputhje me kërkesat e Dokumenteve të Procedurës Konkurruese dhe do të refuzojë Ofertën.

4 PËRGATITJA E OFERTAVE

4.1 Përmbajtja e Ofertës

Dokumentet e Ofertës duhet të përfshijnë sa më poshtë:

- (a) Dokumentet e Kualifikimit, në përputhje me kërkesat e Seksionit 8.

- (b) Ofertën Teknike, në përputhje me kërkesat e Seksionit 9.
- (c) Ofertën Financiare, në përputhje me kërkesat e Seksionit 9.

4.2 Gjuha e Ofertës

Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe, Ofertuesit i përgatisin Dokumentet e Ofertës në gjuhën shqipe. Nëse Dokumentet e Ofertës janë në gjuhën angleze, ato duhet të shoqërohen nga përkthimi i noterizuar (nga një noter publik) në gjuhën shqipe. Broshurat që janë pjesë e Dokumenteve të Ofertës, mund të dorëzohen në gjuhën angleze ose në një gjuhë tjetër të huaj, të shoqëruar nga përkthimi i noterizuar i pjesëve përkatëse në anglisht ose në shqip.

4.3 Referenca të qarta

- 4.3.1 Ofertuesit duhet të përfshijnë në çdo dokument një referim të qartë në faqen dhe paragrafin përkatës të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese.
- 4.3.2 Çdo informacion financiar në lidhje me Procedurën Konkurruese duhet të shprehet në Euro ose Lek (por për të shmangur dyshimet, nëse i njëjti informacion financiar shprehet në të dyja monedhat, Euro dhe Lek, për qëllime të vlerësimit do të përdoret vlera në Lek, ndërsa ajo në Euro nuk do të merret parasysh). Nëse elemente të Ofertës paraqiten në monedhë të huaj, ajo vlerë do të vlerësohet duke iu referuar monedhës vendase. Të gjitha vlerat do të konvertohet sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, të zbatueshëm në ditën e shpalljes së njoftimit të kontratës për këto Dokumente të Procedurës Konkurruese.

4.4 Sigurimi i Ofertës

- 4.4.1 Si pjesë e Dokumenteve të Kualifikimit, Ofertuesi duhet të paraqesë Sigurimin e Ofertës në vlerën 260,119,320 ALL që përfaqëson 2% të vlerës së parashikuar të projektit si pjesë e Dokumenteve Kualifikuese.
- 4.4.2 Sigurimi i Ofertës, është i detyrueshëm të paraqitet në formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë aktivitet. Ofertuesi duhet të garantojë që Sigurimi i Ofertës të mbetet i vlefshëm gjatë Periudhës së Vlefshmërisë së Sigurimit të Ofertës. Pra oferta duhet të sigurohet për një periudhë prej 180 ditëve nga data e përfundimit të afatit të dorëzimit të saj. Për arsye të motivuara Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë nga Ofertuesi zgjatjen e Periudhës së Vlefshmërisë së Sigurimit të Ofertës, nëse ka patur një të tillë, në rast se rrethana të caktuara ndikojnë në shtyrjen e afatit të vlerësimit të Ofertës përkatëse, ose në dorëzimin e Sigurimit të Kontratës ose në çdo rast tjetër që ndikon në shtyrjen e ndonjë afati të detyrueshëm. Mos shtyrja e periudhës së vlefshmërisë së Sigurimit të Ofertës, kur kërkohet, përbën shkak për skualifikimin e Ofertuesit sipas paragrafit 4.5. (*Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës*);
- 4.4.3 Sigurimi i Ofertës i Ofertuesit Fitues mbetet i vlefshëm deri në (i) përfundimin e Periudhës së Vlefshmërisë së Sigurimit të Ofertës, ose deri në (ii) datën në të cilën Koncesionari dorëzon Sigurimin e Kontratës në përputhje me Kontratën e Koncesionit. Në rastin e dytë, Ofertuesi Fitues do të shtyjë përkatësisht afatin e vlefshmërisë së Sigurimit të Ofertës.
- 4.4.4 Sigurimi i Ofertës i një Ofertuesi mund të konfiskohet nëse:
 - (a) Ofertuesi tërheq ose ndryshon Ofertën e tij gjatë Periudhës së Vlefshmërisë së Sigurimit të Ofertës;

- (b) Ofertuesi Fitues, ose çdo Ofertues që vjen pas tij në radhë të cilit i jepet Projekti, nuk nënshkruan kontratën e Koncesionit;
 - (c) Ofertuesi Fitues, ose çdo Ofertues që vjen pas tij në radhë të cilit i jepet Projekti, nuk shtyn Periudhën fillestare të Vlefshmërisë së Sigurimit të Ofertës deri në datën e dorëzimit të Sigurimit të Kontratës në masën 10% të vlerës së kontratës, sipas parashikimeve të Kontratës së Koncesionit;
 - (d) Ka deklaruar të dhëna të rreme; ose
 - (e) Në rast se Ofertuesi Fitues nuk paguan shpenzimet e përcaktuara në paragrafin 3.15 të këtyre Dokumenteve të Procedurës Konkurruese.
- 4.4.5 Sigurimi i Ofertës i kthehet Ofertuesit, pa u konfiskuar, sa më shpejtë të jetë e mundur por jo më vonë se 30 ditë, në rrethanat kur:
- (a) Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës ka përfunduar dhe Ofertuesi ka refuzuar të shtyjë Periudhën e Vlefshmërisë së Sigurimit të Ofertës,
 - (b) Ofertuesi është shpallur fitues dhe ka dorëzuar Sigurimin e Kontratës.

4.5 Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës

- 4.5.1 Ofertat duhet të mbeten të vlefshme për Periudhën e Vlefshmërisë së Ofertës, pra për një periudhë prej 150 ditë nga Afati i Dorëzimit.
- 4.5.2 Përpara përfundimit të Periudhës së Vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktues mund t'u kërkojë, me shkrim, Ofertuesve të zgjasin periudhën e vlefshmërisë me një periudhë shtesë të caktuar dhe Ofertuesi duhet t'i përgjigjetkësajkërkese me shkrim. Ofertuesi mund ta refuzojë një kërkesë të tillë, pa iu konfiskuar Sigurimi i Ofertës (me përjashtim të rasteve kur kjo shtyrje kërkohet sipas dispozitave të paragrafit 4.4.4).
- 4.5.3 Oferta e Ofertuesit Fitues do të jetë e vlefshme deri në nënshkrimin e Kontratës së Koncesionit dhe Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë që periudha e vlefshmërisë së Ofertës së e një Ofertuesi jofitues të zgjatet me një periudhë deri në Datën e Hyrjes në Fuqi (siç përcaktohet në Kontratën e Koncesionit), zgjatje e cila mbetet në gjykimin e Ofertuesit përkatës.

5 DORËZIMI I OFERTAVE

5.1 Afati i Dorëzimit

- 5.1.1 Afati i Dorëzimit të Ofertave është:

Data: 15 shkurt, 2017

Ora: 15:00 Ora e Evropës Qendrore

5.1.2 MSH mund të shtyjë Afatin e Dorëzimit të Ofertës duke i dhënë njoftim të gjithë Ofertuesve.

5.2 Forma e Dorëzimit

5.2.1 Ofertuesit duhet të dorëzojnë Dokumentet e Ofertës elektronikisht, duke i ngarkuar ato përpara Afatit të Dorëzimit, në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, www.app.gov.al. Ofertat e dorëzuara pas Afatit të Dorëzimit (me ndryshimet që mund t'i bëhen) do të refuzohen. Ofertuesit do të dorëzojnë vetëm një Ofertë.

5.2.2 Udhëzimet në shqip dhe anglisht për ngarkimin e Dokumenteve të Ofertës i gjeni në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, www.app.gov.al. Kërkesat për sqarim në lidhje me dorëzimin elektronik të Dokumenteve të Ofertës do t'i paraqiten Personit të Kontaktit.

5.2.3 Çdo faqe e dokumenteve në Ofertën origjinale duhet të ketë numër rendor dhe të jetë e sigluar nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Ofertuesit.

5.2.4 Të gjitha shifrat e shprehura në Ofertë duhet të shprehen në formatin “1,000 (një mijë) (p.sh. tre milion: 3,000,000) dhe në rast mospërputhjeje, fjalët kanë përparësi ndaj numrave.

5.2.5 Çdo Dokument origjinal i Ofertës duhet të jetë i shtypur dhe i shkruar me bojë, e cila nuk fshihet. Përfaqësuesi i Autorizuar i Ofertuesit nënshkruan Dokumentet origjinale të Ofertës dhe i siglon në çdo faqe, me përjashtim të literaturës së pandryshuar, ekzistuese. Dokumentet e Ofertës nuk duhet të kenë ndryshime, fshirje apo shtesa, me përjashtim të rastit kur korrigjimet nënshkruhen nga personi apo personat me të drejtën e nënshkrimit të Dokumenteve të Ofertës.

5.2.6 Çdo Ofertues mban Dokumentet origjinale të Ofertës deri në momentin që nuk është më pjesëmarrës në Procedurën Konkurruese ose përzgjidhet Ofertuesi Fitues nga Autoriteti Kontraktues. Pas mbylljes së Procedurës Konkurruese dhe përpara nënshkrimit të Kontratës së Koncesionit, Ofertuesi që zgjidhet Ofertuesi Fitues dorëzon Dokumentet origjinale të Ofertës për verifikim. Çdo Ofertues, Ofertues i Kualifikuar ose Ofertues Fitues që jep informacion të rremë në Dokumentet e dorëzuara elektronikisht, përjashtohet nga Procedura Konkurruese.

5.2.7 Ofertuesi Fitues duhet të dorëzojë ofertën origjinale pranë Autoritetit Kontraktues në adresën e përcaktuar në paragrafin 1.1. Oferta origjinale duhet të vendoset në një zarf/kuti, të jetë e mbyllur dhe e vulosur. Mbi zarf/kuti duhet të jetë pasqyruar emri dhe adresa e Ofertuesit si dhe shënimi: Ofertë për Projektin “Koncesioni i Laboratorëve Mjekësorë në Spitale në Shqipëri”.

6 NDRYSHIMI DHE TËRHEQJA E OFERTAVE

6.1 Kërkesat për informacion shtesë

Ofertuesi njofton menjëherë Autoritetin Kontraktues kur mendon se ka mospërputhje, gabime, apo paqartësi në Procedurën Konkurruese, në Dokumentet e Procedurës Konkurruese ose në çdo informacion të dhënë nga Autoriteti Kontraktues, në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të bëjë rregullimet që gjykon me vend.

6.2 Ndryshimi dhe tërheqja e Ofertave

Ofertuesi mund të ndryshojë ose të tërheqë Ofertën e tij, pa penaltete, pasi e ka dorëzuar, me kusht që Autoritetit Kontraktues t'i dërgohet njoftim për ndryshimin apo tërheqjen, përpara Afatit të Dorëzimit.

6.3 Gabimet e paqëllimshme në Ofertë

Autoriteti Kontraktues nuk pranon asnjë ndryshim apo shtesë në Ofertë pas Afatit të Dorëzimit. Autoriteti Kontraktues nuk mban përgjegjësi për humbjet apo pasojat që vijnë nga gabimet në Ofertë. Nëse pas Afatit të Dorëzimit, një Ofertues vendos të tërheqë Ofertën, për shkak të një gabimi, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të mbajë Sigurimin e Ofertës.

7 RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E OFERTAVE

- 7.1 Pas mbarimit të Afatit të Dorëzimit të Ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave bën identifikimin e Ofertuesve dhe hapjen e Ofertave të dorëzuara në faqen e internetit të APP-së.
- 7.2 Vetëm Ofertat e Ofertuesve të Kualifikuar do të merren parasysh për vlerësim nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.
- 7.3 Ofertat do të kualifikohen në përputhje me kriteret dhe rregullat e Seksionit 8 dhe më tej do t'i nënshtrohen vlerësimit në përputhje me kriteret dhe rregullat e përcaktuara në Seksionin 9.
- 7.4 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mund të kërkojë sqarime me shkrim nga Ofertuesi, kur e sheh me vend ose të nevojshme (por pa qenë i detyruar). Në rast se bëhet një kërkesë e tillë, Ofertuesi duhet t'i paraqesë Komisionit të Vlerësimit të Ofertave sqarimet me shkrim deri në datën e specifikuar nga Komisioni.
- 7.5 Komisioni e vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime apo parregullsi të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht dhe nuk cenojnë vlerësimin e Ofertës në përputhje me kushtet e kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Procedurës Konkurruese.
- 7.6 Autoriteti Kontraktues ose Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mund të kërkojë të asistohet nga ose të këshillohet me ekspertë apo institucione të tjera shtetërore (duke përfshirë ata ligjorë, financiar apo teknikë) gjatë procesit të vlerësimit të Ofertave. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të shqyrtojë çdo sugjerim, vlerësim apo këshillë të dhënë nga ekspertët apo institucionet e tjera shtetërore, si pjesë përkatëse e procesit të vlerësimit të Ofertës.
- 7.7 Autoriteti Kontraktues mund të kryejë çdo hetim të arsyeshëm ose procedurë të ngjashme që e gjykon të nevojshëm për të shqyrtuar integritetin dhe gjendjen financiare në lidhje me Ofertën e një Ofertuesi.
- 7.8 Ofertuesi duhet të japë menjëherë informacionin dhe asistencën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e çdo hetimi të nevojshëm..

8 KUALIFIKIMI I OFERTAVE

8.1 Kualifikimi i Ofertave

Përpara vlerësimit të Ofertave Teknike dhe Financiare, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të kryejë një shqyrtim të detajuar të Dokumenteve të Kualifikimit që janë dorëzuar si pjesë e Ofertës, në mënyrë që të vendosë nëse Ofertuesi kualifikohet për vlerësimin e Ofertës Teknike dhe Financiare.

8.2 Dokumentet e Kualifikimit

Dokumentet e Kualifikimit përmbajnë të gjithë dokumentet e përcaktuar në Shtojcën 9 dhe 9/1.

8.3 Shqyrtimi i Dokumenteve të Kualifikimit

- 8.3.1 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të shqyrtojë Dokumentet e Kualifikimit të çdo Ofertuesi, për të verifikuar nëse janë dorëzuar dhe nëse janë nënshkruar siç duhet të

gjitha dokumentet e kërkuara nga Seksionet 1.1.2, 1.1.3 dhe 1.1.4 të Shtojcës 9 (“**Shqyrtimi Paraprak**”).

8.3.2 Çdo Dokument i Kualifikimit (duke përfshirë informacionin ose dokumentacionin shtesë) që konstatohet se nuk përmban të gjitha dokumentet e nënshkruara siç duhet, sipas kërkesave të Seksioneve 1.1.2, 1.1.3 dhe 1.1.4 të Shtojcës 9 do të refuzohet nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe nuk do të merret parasysh më tej.

8.3.3 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të kryejë vlerësimin e detajuar të Dokumenteve të Kualifikimit që nuk janë refuzuar nga Shqyrtimi Paraprak, për të përcaktuar nëse ato përmbushin Kriteret e Kualifikimit. Për të arritur në këtë përfundim, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të shqyrtojë informacionin dhe dokumentacionin e dorëzuar nga çdo Ofertues dhe do të mbajë parasysh faktorët e mëposhtëm:

Kriteret e Kualifikimit të përcaktuara në seksionin 1.1.1 Pjesa I të Shtojcës 9, do të vlerësohen me “kalon” / “nuk kalon” për çdo kriter.

8.3.4 Një Ofertues, Dokumentet e Kualifikimit të cilit janë vlerësuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave se përmbushin Kriteret e Kualifikimit të përcaktuara në Seksionin 1.1.1 Pjesa I të Shtojcës 9, do të përcaktohet si “**Ofertues i Kualifikuar**”.

8.3.5 Një Ofertues, Dokumentet e Kualifikimit të cilit janë vlerësuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave se nuk përmbushin Kriteret e Kualifikimit të përcaktuara në Seksionin 1.1.1 Pjesa I të Shtojcës 9, do të përcaktohet si “**Ofertues i Skualifikuar**”.

8.3.6 Pas vlerësimit të Dokumenteve të Kualifikimit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:

- përcakton Ofertuesin si Ofertues të Skualifikuar dhe refuzon Ofertën e tij, me arsyen se ajo nuk përmbush të gjitha Kriteret e Kualifikimit/ose kërkesat e tjera të përcaktuara në Seksionet 1.1.2, 1.1.3 dhe 1.1.4 të Shtojcës 9, rast në të cilin Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Ofertuesin e Skualifikuar sipas Shtojcës 15 (*Formulari i Njoftimit të Ofertuesit të Skualifikuar*); ose,
- përcakton Ofertuesin si Ofertues të Kualifikuar dhe vijon me vlerësimin e Ofertës së tij, sipas Seksionit 9.

9 VLERËSIMI I OFERTAVE DHE KLASIFIKIMI PËRFUNDIMTAR

9.1 Oferta Teknike

Çdo Ofertues do të paraqesë Ofertën e tij Teknike duke dorëzuar formularin e përcaktuar në Shtojcën 26 (*Formulari i Ofertës Teknike*) të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese.

9.2 Oferta Financiare

Ofertuesit duhet të dorëzojnë formularin e përcaktuar në Shtojcën 1 (*Formulari i Ofertës Financiare*) të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese, që përmban listën e analizave që do të kryhen sipas tarifave të rregulluara nga Autoriteti Kontraktues. Ofertuesit duhet të ofrojnë një zbritje uniforme në përqindje (me tre shifra pas presjes dhjetore) për tarifatat e përcaktuara në Shtojcën 1.

9.3 Vlerësimi dhe Klasifikimi Përfundimtar

- 9.3.1 Ofertat e Ofertuesve të Kualifikuar do të vlerësohen nëse përmbushin kërkesat dhe objektivat e Autoritetit Kontraktues për Projektin e përcaktuar në Dokumentet e Procedurës Konkurruese.
- 9.3.2 Oferta Teknike dhe Financiare do të vlerësohet dhe kategorizohet në bazë të kritereve të përcaktuara në Shtojcën 11 (*Kriteret e Vlerësimit dhe Metodologjia e Vendosjes së Pikëve*)ku peshat e Propozimit Teknik zë 60% të pikëve të përgjithshme dhe Propozimi Financiar zë 40 % të pikëve të përgjithshme.
- 9.3.3 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave harton renditjen përfundimtare e cila u njoftohet të gjithë Ofertuesve. Ofertuesi i Kualifikuar që merr pikët më të larta, sipas metodologjisë së përcaktuar në Shtojcën 11 dhe që ka dorëzuar një Ofertë të rregullt, do të deklarohet si Ofertues i preferuar (“**Ofertues i Preferuar**”).
- 9.3.4 Çdo Ofertues mund të kërkojë rishikim administrativ të procesit të vlerësimit, nëse gjykon se një veprim i ndërmarrë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ose nga Autoriteti Kontraktues është në kundërshtim me parashikimet e Ligjit për PPP, Ligjit për Prokurimin Publik ose të çdo ligj tjetër të zbatueshëm. Çdo ankesë që i drejtohet Komisionit të Prokurimit Publik do të bëhet në formën e përshtatshëm në Shtojcën 21/1 (*Formulari i Ankimit i Procedurës Konkurruese*) ku shkruhet emri dhe adresa e ankimuesit, cilësohet procedura përkatëse, baza ligjore dhe përkrahimi i shkeljes.
- 9.3.5 Pas përfundimit të procesit të ankimimit ose të afatit të ankimuesit përkatës, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave përgatit raportin përfundimtar të vlerësimit të Ofertave dhe informon përkatësisht Autoritetin Kontraktues për rezultatet e Ofertuesve dhe Ofertuesin e Preferuar.
- 9.3.6 Autoriteti Kontraktues njofton Ofertuesin e Preferuar se ai është Ofertuesi Fitues duke i dërguar Formularin e Njoftimit të Ofertuesit Fitues (Shtojca 16). Një version më i zgjeruar i këtij njoftimi publikohet në buletin e APP-së.

10 NËNSHKRIMI I KONTRATËS SË KONCESIONIT

- 10.1 Pas përfundimit të afatit të ankimimit dhe të çdo rishikimi administrativ, siç parashikohet në Ligjin për Prokurimin Publik dhe në Ligjin për PPP, Autoriteti Kontraktues vijon me nënshkrimin e Kontratës së Koncesionit.
- 10.2 Do të ketë negociatë të kufizuara mes Ofertuesit Fitues dhe Autoritetit Kontraktues për dispozita të kontratës, duke përjashtuar kushtet kryesore të koncesionit në përputhje me ofertën teknike dhe financiare, strukturën e çmimeve të Projektit, ndarjen e riskut dhe kushte kryesore tregtare, dhe më pas Kontrata e Koncesionit do të lidhet kryesisht në formën e bashkëngjitur në Shtojcën 17 (*Draft Kontrata e Koncesionit*) të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese.
- 10.3 Kontrata e Koncesionit ndryshohet vetëm atëherë kur është e nevojshme, në mënyrë që: (i) të pasqyrohet Oferta e Ofertuesit Fitues dhe ndryshimet e nevojshme për adresimin e atyre ndryshimeve vijuese, nëse ka, të cilat janë identifikuar përpara Afatit të Dorëzimit në përgjigje të pyetjeve; (ii) të plotësohen boshllëqet; (iii) të korrigjohen gabimet ose mangësitë, por në asnjë rast për të ndryshuar Ofertën Teknike dhe Financiare të Ofertuesit Fitues.
- 10.4 Pas përfundimit të procesit të vlerësimit dhe shpalljes së Ofertuesit Fitues, Autoriteti Kontraktues vendos afatin për nënshkrimin e Kontratës së Koncesionit, që parashikohet të jetë jo më shumë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike nga dalja e

vendimit në fjalë. Ky afat mund të shtyhet sipas gjykimit dhe vendimit të Autoritetit Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të publikojë në Buletinin e Njoftimeve Publike emrin e Koncesionarit dhe termat kryesore të Kontratës së Koncesionit brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

10.5 Ofertuesi në Ofertën e dorëzuar angazhohet që në rast se do të shpallet Ofertuesi Fitues, në përputhje me legjislacionin shqiptar, do të themelojë shoqërinë për qëllim të veçantë (SPV), për realizimin e Projektit, i cili do të nënshkruajë Kontratën e Koncesionit dhe do të marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Ofertuesit Fitues, njësoj sikur Koncesionari të kishte qenë fillimisht Ofertuesi Fitues.

10.6 Kontrata e koncesionit/ PPP do të hyjë në fuqi pas miratimit të saj nga Këshilli i Ministrave.

11 NEGOCIMI I PASUKSESSHËM ME OFERTUESIN FITUES

11.1 Kur Autoriteti Kontraktues konstaton se negociatat me Ofertuesin Fitues nuk do të finalizohen me nënshkrimin e Kontratës së Koncesionit, atëherë Autoriteti Kontraktues mund të ftojë në negociata Ofertuesin e Kualifikuar të renditur i dyti dhe nëse nuk arrin marrëveshje as me Ofertuesin e Kualifikuar të renditur i dyti, do të ftojë për negociim Ofertuesin e Kualifikuar të renditur i treti e kështu me radhë.

11.2 Autoriteti Kontraktues, sipas dispozitave të legjislacionit përkatës, mund të refuzojë të hyjë në negociata me Ofertuesit e tjerë të Kualifikuar kur negociatat me Ofertuesin e parë Fitues dështojnë dhe Ofertuesi i parë Fitues nuk nënshkruan Kontratën e Koncesionit

12 KUFIZIME

12.1 E drejta për të pezulluar Procedurën Konkurruese

Autoriteti Kontraktues gëzon të drejtën që, sipas dispozitave të legjislacionit përkatës, të pezullojë Procedurën Konkurruese qoftë në mënyrë të përkohshme apo të përhershme, pas çdo vendimi të marrë prej tij në rast riorganizimi të brendshëm ose në çdo situatë tjetër të paparashikuar. Ofertuesit nuk do të kenë asnjë të drejtë të marrin kompensim për humbje e fitimit, për kostot apo shpenzimet në rastin e pezullimit të Procedurës Konkurruese.

12.2 E drejta për ta deklaruar Procedurën Konkurruese “të pasuksesshme”

Autoriteti Kontraktues do ta quajë Procedurën Konkurruese të pasuksesshme kur:

- Nuk është dorëzuar asnjë Ofertë;
- Asnjë Ofertues nuk kualifikohet në bazë të Dokumenteve të Kualifikimit;
- Asnjë nga Ofertat nuk përmbush kërkesat e Ofertës; ose
- Autoriteti Kontraktues vendos që Projekti ose Ofertat nuk ofrojnë leverdi ekonomike apo zgjidhje të pranueshme për Autoritetin Kontraktues.

12.3 E drejta për ta deklaruar Ofertën të pavlefshme

Oferta do të konsiderohet e pavlefshme nëse:

- Ofertuesi nuk ka dorëzuar Sigurimin e Ofertës
- Oferta përmban të dhëna të rreme;
- Nuk ka plotësuar një ose të gjitha kërkesat e Dokumenteve të Procedurës Konkurruese.

SHTOJCA 1
FORMULARI I OFERTËS FINANCIARE

SHËNIM PËR OFERTUESIT:

Ofertuesit duhet të ofrojnë vlerën e Zbritjes Uniforme në Përqindje (me tre shifra pas presjes dhjetore) krahas listës së tarifave të testeve të publikuar mëposhtë.

Ofertuesit me zbritjen më të madhe marrin 40 pikë. Oferta më e ulët merr numrin proporcional të pikëve, të rrumbullakosur në shifrën pasardhëse, p.sh. nëse Ofertuesi A kuoton x% zbritje nga tarifa dhe Ofertuesi B kuoton y%

Dhe $x > y$

Atëherë,

x% merr 40 pikë

y% merr $y\%/x\% * 40$ pikë³

Emri i Ofertuesit _____

Për: Ministria e Shëndetësisë

Procedura e Koncesionit/PPP: E hapur

Përshkrim i shkurtër i Kontratës: Financimi, projektimi, rinovimi, pajisja, riorganizimi, dhe funksionimi i shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale, dhe atyre bashkiake të Sarandës e Lushnjës).

Publikimi (nëse e zbatueshme): Buletini i Njoftimeve Publike nr. ____ datë ____

Në lidhje me procedurën e mësipërme, ne të nënshkruarit, ofrojmë Zbritjen Uniforme në Përqindje të mëposhtme:

[shtoni shifrën]

Nënshkrimi i Ofertuesit _____

Vula

[Lista përmban çmimet aktuale për çdo test të cilat do të ndryshohen bazuar në zbritjen e ofruar nga Ofertuesi Fitues. Çmimet e përditësuara do të jenë pjesë përbërëse e Kontratës së Koncesionit]

Lista Referencë e Testeve Laboratorike Mjekësore në Shqipëri

	ID	Teste diagnostikuese	Urgjente	Lista e çmimeve në Lek
1. Clinical chemistry				
1.1. Specimen/sample: Blood				
1.1.1. Substrates	1	Uric acid	Jo	240
	2	Creatinine	Po	240
	3	Urea	Po	240
	4	Bicarbonates	Po	240

³ Shënimi për Ofertuesit së bashku me listën e testeve dhe tarifave të rregulluara mund të hiqen nga Formulari i Ofertës Financiare i plotësuar nga Ofertuesi në kohën e dorëzimit të Ofertës.

	5	Total proteins	Jo	240
	6	Bilirubine total	Po	240
	7	Bilirubine direct	Po	240
	8	Glucose	Po	240
1.1.2. Ions	9	Calcium, Total	Po	200
	10	Chloride	Po	190
	11	Iron, serum	Jo	240
	12	Complete serum ions screening (Na+K+Cl+Bicarbonate+Total proteins)	Po	380
	13	Reduced serum ions screening (Na + K + Cl)	Po	300
	14	Sodium	Po	370
	15	Potassium	Po	410
	16	Magnesium, plasma	Jo	200
	17	Phosphorus	Jo	490
1.1.3. Lipids	18	Cholesterol, Total	Jo	310
	19	HDL cholesterol	Jo	290
	20	LDL Cholesterol	Jo	290
	21	HCG RDT (1.1.7 hormones)	Po	200
	22	Triglycerids	Jo	260
	23	Lipids abnormality screening, include: Serum aspect, Total Cholesterol, HDL cholesterol, Triglycerids and LDL cholesterol	Jo	640
1.1.4. Proteins and vitamins	24	Albumin, serum	Jo	230
	25	Quantitative hemoglobin electrophoresis	Jo	640
	26	Proteins electrophoresis with percentages and Total proteins	Jo	790
	27	Glycated Haemoglobin (Hb A1c)	Jo	560
	28	Emmel test (Sickling) for HbS screening	Jo	900
	29	C-reactive protein, semi-quantitative (agglutination)	Po	390
	30	C-reactive protein, quantitative by immunology method	Po	400
	31	Troponin I, semi-quantitative by rapid daignostic test	Po	1,750
	32	Troponin I, quantitative test by immunologic method	Po	1,180
	33	N-terminal pro b-type Natriuretic Peptide (NT-proBNP or BNP)	Po	2,050
1.1.5. Blood gas	34	Lactate	Po	330
	35	Blood pH	Po	960
	36	Blood gas, (including pH, pO ₂ , pCO ₂ , SaO ₂ , H ₃ CO, Hb)	Po	690
	37	Blood gas full (blood gas + Na, K, Ca-i)	Po	1,380
1.1.6. Enzymes	38	Amylase, Total	Po	190
	39	Amylase, pancreatic	Po	2,760
	40	Creatine kinase (CK)	Po	240
	41	Creatine kinase MB fraction	Po	490
	42	Gamma Glutamyl transferase (GGT)	Po	320
	43	Glucose 6 Phosphate dehydrogenase (G6PD)	Jo	890
	44	Lactates dehydrogenase	Po	240

	45	Alkaline phosphatase	Po	240
	46	Lipase	Po	240
	47	Alanine amino transferase (ALT)	Po	240
	48	Aspartate amino transferase (AST)	Po	240
1.1.7. Hormones	49	Beta HCG, quantitative	Jo	1,200
	50	Cortisol	Jo	1,200
	51	Dehydroepiandrosterone (DHEAS)	Jo	1,200
	52	Ferritin	Jo	1,200
	53	Follicle stimulating hormone FSH	Jo	1,200
	54	Luteinizing hormone (LH)	Jo	1,200
	55	Progesterone	Jo	940
	56	Prolactin	Jo	1,200
	57	Testosterone	Jo	1,200
	58	Thyreo Stimulating hormon, ultra sensitive	Jo	1,660
	59	Free Triiodothyronine (FT3)	Jo	1,200
	60	Free Thyroxine (FT4)	Jo	1,200
1.2. Specimen/sample: urine	61	Urinalysis, Complete	PO	160
	62	Urinalysis, sediment	Jo	280
	63	Microalbumin, quantitative	Jo	820
	64	Total proteins, 24 hours	Jo	200
	65	Bences Jones proteins, urine	Jo	3,450
1.3. Other specimens: CSF, semen, feces, ascite, pleural fluid, etc)	66	Glucose CSF	Po	210
	67	Total proteins CSF	Po	410
1.4. Functional/dynamic explorations/tests	68	Creatinine clearance measurement	Jo	510
	69	Induced hyperglycemia by oral route or OGTT	Jo	640
2. Hematology- Immunohematology- Hemostasis				
2.1. Routine hematology	70	Complete Blood Count with, Hemoglobin, Hematocrit, MCV,MCH, MCHC, RDW, WBC, Platelets, approx DIFF	Po	400
	71	Complete Blood Count with differential: RBC, Hemoglobin, Hematocrit, MCV,MCH, MCHC, RDW, WBC, Neutrophils, Lymphocytes, Monocytes, Eosinophils, Basophils, Platelets, PDW	Jo	400
	72	Microscopic examination of Blood film (WBC differential, RBC morphology)	Jo	700
	73	Erythrocyte Sedimentation Rate (ESR)	Po	100
	74	Reticulocytes count,	Jo	210
	75	Bone marrow – Cytomorphology	Jo	1,940
	76	Cytomorphology - CSF	Jo	1,020

	77	Cytomorphology - ascite/biological liquids /pleural/articulation, etc.	Jo	830
2.3. Hemostasis - Coagulation	78	D-dimer, qualitative, plasma	Po	450
	79	D-dimer, quantitative	Po	1,340
	80	Heparinemia (anti-Xa activity)	Jo	1,050
	81	Fibrinogen Activity , plasma	Po	300
	82	Prothrombine time (Quick time)	Po	340
	83	Prothrombine time (Quick time) and INR	Po	300
	84	Activated Partial Thromboplastin Time (aPTT)	Po	300
	85	Bleeding time, Ivy 3 points Method	Po	460
	86	Thrombin time (TT)	Jo	210
2.4.Immuno-Hematology, Blood transfusion	87	ABO Grouping and RhD, Blood	Po	300
	88	Rhesus and Kell phenotyping, Blood	Po	2,640
	89	Direct antiglobulin test (Coomb test)	Po	560
	90	Indirect antiglobulin test (Screening)	JO	1,380
	91	Crossmatch test (Compatibility test)	Po	15,110
3. Immunology/Serology				0
3.1. Bacterial serology/Immunology	92	Antistreptolysin test (ASLO), semi-quantitative	Jo	440
	93	Syphilis serlogy screening test	Jo	210
	94	Syphilis confirmatory test (Serology)	Jo	460
3.2. Viral seroimmunology	95	Anti-hepatitis A antibody (HAV-Ab), IgM	Jo	1,200
	96	Anti-hepatitis A antibody (HAV-Ab), IgG	Jo	1,200
	97	Anti-hepatitis A antibody (HAV-Ab), Total	Jo	1,200
	98	Hepatitis B surface antigen (HBsAG), RDT	Jo	930
	99	Hepatitis B surface antigen (HBsAG), Automated	Jo	1,160
	100	Hepatitis B surface antibody (anti-HBs)	Jo	1,160
	101	Total anti-hepatitis B core (anti-HBc, IgM and IgG)	Jo	1,210
	102	Anti-hepatitis B core (anti-HBc), IgM	Jo	1,210
	103	Hepatitis B e-antigen (HBeAG)	Jo	1,130
	104	Anti-hepatitis B e antibody (Anti-HBe)	Jo	1,080
	105	HIV 1&2 Antibody, RDT	Po	280
	106	HIV 1&2 Antibody, Automated (CMIA, ELFA, etc)	Jo	1,000
	107	Hepatitis C Antibody , ELISA or CMIA or ELFA etc.	Jo	2,010
3.3. Parasites	108	Toxoplasma IgM antibodies	Jo	1,200

Seroimmunology				
	109	Toxoplasma IgG antibodies.	Jo	1,200
	110	Malaria RDT (pan)	Po	800
3.4. Immunoallergy - Autoimmunityv- immune deficiency - Histocompatibility	111	Lymphocytes T CD4 count	Jo	0
	112	HLA typing (1 loci) per individual	Jo	7,850
	113	HLA typing (3 loci) per individual	Jo	23,550
	114	HLA Cross -Match donor / recipient	Jo	15,110
	115	Rheumatoid factor, quantitative	Jo	350
	116	Rheumatoid factor, semi-quantitative	Jo	790
3.5. Tumor markers	117	Alpha-feto protein (AFP), quantitation	Jo	1,200
	118	Carcino-embryonic antigen (CEA)	Jo	1,200
	119	Free Prostate specific antigen (f PSA)	Jo	880
	120	Prostate specific antigen (PSA)	Jo	860
	121	Cancer antigen 125 (CA-125)	Jo	1,200
	122	Cancer antigen 19-9	Jo	1,200
	123	Cancer antigen 15-3	Jo	1,200
	124	Beta-2 microglobulin	Jo	900
	125	Human epidermal growth factor receptor 2 (HER2), EIA, Serum method IHC, EIA serum, etc.	Jo	2,370
	126	Human chorionic gonadotropin, free (Beta hCG)	Jo	850
4. Bacteriology	127	Urine culture	Jo	640
	128	Feceas culture	Jo	630
	129	Throat swab culture	Jo	640
	130	vaginal secretions culture	Jo	800
	131	Vaginal discharge wet mount	Jo	400
	132	Blood culture, aerobic	Po	1,200
	133	Urethral secretions culture	Jo	630
	134	Urethral discharge wet mount+Gram	Jo	630
	135	Ear secretions culture	Jo	400
	136	Nasal secretions culture	Jo	240
	137	Conjunctival secretions culture	Jo	570
	138	Purulent collection culture	Jo	570
	139	Bacterial Wound Culture	Jo	570
	140	CSF culture	Po	720
	141	CSF microscopy/cell counting	PO	690
	142	Antimicrobial susceptibility testing (AST)	Jo	380
	143	Anaerobic pathogens culture	Jo	2,340
	144	Specific bacterial culture (Campylobacter, Helicobacter)	Jo	1,610
5. Parasitology- Mycology	145	Parasitic examination (Ova & Parasites), Stool	Jo	500
	146	Fungal Culture, kin scrapings, hair or nail clippings	Jo	480
	147	Fungal Culture, vaginal secretions	Jo	570

6. Molecular biology-	148	Hepatitis C Viral Load	Jo	15,460
	149	Hepatitis B Viral Load	Jo	16,160
7. Toxicology (Therapeutic Drugs Monitoring and Toxics)	150	Alcohol/volatiles, serum, medical	Po	490
	151	Phenobarbital	Po	1,490
	152	Digoxin	Po	1,140
	153	Everolimus	Jo	3,850
	154	Sirolimus	Jo	1,780
8. Cytology- Histology -pathologic	155	Complete histopathological examination (Hematoxylin Eosin staining)1-3 blocks	Jo	4,820
	156	Complete histopathological examination (Hematoxylin Eosin staining) 4-6 blocks	Jo	4,140
	157	Cytochemistry tests, \geq 4 markers	Jo	4,830
	158	Immunohistochemical Tests, 3 antibodies	Jo	4,430
	159	Cytodiagnostic sputum by paraffin inclusions (1-3 blocks)	Jo	3,710
	160	Cervical-vaginal cytology by Papanicolaou Smear And Stain	Jo	1,490

FTESA PËR OFERTË⁴

NUK ËSHTË E ZBATUESHME

(shkruani emrin e Autoritetit Kontraktor)

Fton për të paraqitur oferta për kryerjen e Shërbimeve të mëposhtme:

.....
.....
.....

...

(jepni një përshkrim të saktë të objektit të kontratës dhe sasive siç përkufizohet në Dokumentacionin Standart të Koncesioneve dhe partneritetit publik privat (DSK/PPP)).

Vendi i kryerjes së kontratës së shërbimit

(jepni një përshkrim të shkurtër)

Afati i ekzekutimit të kontratës _____

Oferta duhet të paraqitet

.....

.[jep adresën e saktë]

Përpara

.....

.[Përcaktoni datën dhe kohën e afatit përfundimtar]

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të web-it të APP-së, www.app.gov.al

⁴ Kjo shtojcë është e aplikueshme për procedurën e kufizuar dhe procedurën me negociim me shpallje paraprake

SHTOJCA 3
FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS
(Logo e Bankës/Shoqërisë së Sigurimit)

Datë []

Përfituesi: Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Shqipërisë

Në emër të: [Emri dhe adresa e Koncesionarit]

Procedura e Koncesionit/PPP: E hapur

Përshkrim i shkurtër i Kontratës: Financimi, projektimi, rinovimi, pajisja, riorganizimi, dhe funksionimi i rrjetit të laboratorëve publikë në disa spitale në Shqipëri (Projekti PPP i Laboratorëve Spitalorë në Shqipëri).

Publikimi (nëse e zbatueshme): Buletini i Njoftimeve Publike nr. ____ datë ____

Në lidhje me procedurën e mësipërme, jemi informuar se _____ (në vijim referuar si "Ofertuesi") i është kërkuar nga ju të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor Sigurimin e Ofertës në vlerën prej [vlera e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e Ofertës që i dorëzohet Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Shqipërisë në lidhje me Projektin PPP për Laboratorët Spitalorë në Shqipëri.

Gjithashtu, ne kuptojmë që sipas kushteve tuaja, ofertat duhet të mbështeten nga garancia e ofertës.

Banka merr përsipër të transferojë në llogarinë e Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Shqipërisë, këtë garanci bankare, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa e parë me shkrim e Autoritetit Kontraktor, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushteve të mëposhtme:

- Ofertuesi ka tërhequr ose ka ndryshuar Ofertën gjatë periudhës së vlefshmërisë së Ofertës;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës dhe/ose ka refuzuar të nënshkruajë Kontratën e Koncesionit brenda afateve të përcaktuara në Shtojcën 5 – Formulari i Deklarimit të Ofertës;
- Ofertuesi ka ofruar ose është përpjekur t'u ofrojë shpërblim punonjësve të Autoritetit Kontraktor që kanë lidhje me Projektin;
- Ofertuesi ka bërë deklarime të rreme në Ofertën e tij;
- Ofertuesi nuk kryen pagesat në përputhje me paragrafin 3.15 (Kostot) të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese brenda periudhës së përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor.

Kjo garanci është e vlefshme deri më [_____]2017, dhe çdo kërkesë për vlerën e garancisë duhet të merret nga Banka përpara kësaj date.

[Nënshkrimi dhe vula e Bankës/shoqërisë së Sigurimit]

SHTOJCA 4
LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Ofertuesi]

(Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial	Numri i faqeve dhe pikat në dokumentet e tenderit që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial	Afati kohor gjatë së cilit ky informacion duhet të mbahet konfidencial

SHTOJCA 5

FORMULARI I DEKLARIMIT TË OFERTËS

Procedura e Koncesionit/PPP: E hapur

Përshkrim i shkurtër i Kontratës: Financimi, projektimi, rinovimi, pajisja, riorganizimi, dhe funksionimi i rrjetit të laboratorëve publikë në disa spitale në Shqipëri (Projekti PPP i Laboratorëve Spitalorë në Shqipëri).

Publikimi (nëse e zbatueshme): Buletini i Njoftimeve Publike nr. ____ datë ____

Duke iu referuar Procedurës Konkurruese të lartpërmendur, ne, të nënshkruarit _____, në cilësinë e _____, deklarojmë se:

- A. pasi shqyrtoam Dokumentet e Procedurës Konkurruese, pranojmë pa rezerva kërkesat, afatet dhe kushtet e përcaktuara në Dokumentet e Procedurës Konkurruese;
- B. përmbushim kërkesat ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese;
- C. Oferta jonë është e vlefshme për periudhën e shkruar në Dokumentet e Procedurës Konkurruese;
- D. nëse oferta jonë pranohet, ne do të ofrojmë Sigurimin e Kontratës në përputhje me Dokumentet e Procedurës Konkurruese;
- E. nuk do të marrim pjesë si Ofertues në më shumë se një Ofertë në këtë Projekt;
- F. autorizojmë Autoritetin Kontraktor të verifikojë informacionin dhe dokumentet bashkëngjitur kësaj Oferte;
- G. jemi dakord të nënshkruajmë Kontratën e Koncesionit në formën e draft Kontratës së Koncesionit (të përshtatur në përputhje me paragrafin 10 të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese) nëse shpallemi Ofertuesi Fitues;
- H. njohim dhe pranojmë që Ministria ka emëruar International Finance Corporation ("IFC"), anëtare e Grupit të Bankës Botërore, si Këshilltar për Transaksionin. Pranojmë se IFC mund të ketë ose mund të mendojë të blejë interesa financiarë në një ose më shumë ofertues të mundshëm, dhe/ose mund t'i kërkojë të financojë ofertuesin fitues pasi të zgjidhet. Ne (a) pranojmë dhe japim pelqimin për çdo konflikt aktual ose të mundshëm që mund të lindë nga rolet e shumëfishta të IFC-së (qoftë aktuale apo të ardhshme) në lidhje me Projektin PPP, konkretisht si Këshilltar Transaksioni për Ministrinë dhe (sipas rastit) si investitor (qoftë aktual apo i mundshëm) në çdo Ofertues, Ofertues Fitues apo çdo Ofertuesi të mëpasshëm të cilit mund t'i jepet Projekti ose filialet e tij ose të tyre dhe (b) pranojmë se IFC ka zbatuar masat për administrimin dhe reduktimin e këtyre konflikteve që mund të lindin (ose që mendohet të lindin), duke përfshirë ngritjen e ekipeve të ndara të këshillimit dhe të investimit dhe mirëmbajtjen e masave mbrojtëse të informacionit konfidencial, dhe (c) lirojmë nga çdo përgjegjësi për të cilën Ministria ose këshilltarët e saj mund të kishin pasur, në lidhje me konfliktin e interesit aktual ose të mundshëm.
- I. kuptojmë se ju mund të anuloni Procedurën e Konkurrimit në çdo kohë, se nuk jeni të detyruar të pranoni cilëndo nga Ofertat që mund të merrni dhe se ftoni Ofertuesit të ofertojnë për Projektin, pa shkaktuar detyrime për Ofertuesit, në përputhje me paragrafin 12 të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese. Pranojmë dhe kuptojmë se Oferta është objekt i parashikimeve të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese. Ne nuk do të kemi në asnjë rast, asnjë pretendim apo të drejtë të asnjë lloji natyre, në rast se nuk shpallemi fitues i koncesionit.

Data e Deklaratës:

Ofertuesi ose Anëtari Kryesues i Bashkimit të Shoqërive:

Nënshkrimi:

Vula:

SHTOJCA 6
DEKLARATË MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Për: [Emri i Autoritetit Kontraktor]

Ne, [Emri i Ofertuesit] marrim pjesë në procedurën konkurruese që do të zhvillohet më datë [•] 2017, e shpallur nga Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Shqipërisë, për Projektin PPP për Laboratorët Spitalorë në Shqipëri, me vlerë kontrate [•].

Konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohe në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë publike janë:

